



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · eëë.uni-pr.edu

Fakulteti: Bujqësisë dhe veterinarisë

Departamenti: Pemëtari - Vreshtari

Programi: Pemëtari Vreshtari

NJOFTIM

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se :

Ekzemplari (drafti) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja Diellza Uka, me titull: **”Ndikimi i mikorizës në parametrat biomorfologjik të boronicës – kultivarët Duke, Liberty, Draper**

ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data 25.02.2025 deri me datë 04.03.2025.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. Bedri Dragusha kryetar
2. Prof. asoc. Vahid Avdiu mentor - anëtar,
3. Prof. ass. Muhamet Zogaj, anëtar

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte te udhëheqësi shkencor i temës Prof. asoc. Vahid Avdiu, përmes e-mail adresës vahid.avdiu@uni-pr.edu.

Për të pasur një informacion paraparak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji është i mirëseardhur dhe mund të jetë një pasurim i punës tonë !

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË

DEPARTAMENTI PEMËTARI -VRESHTARI

PROGRAMI PEMËTARI DHE VRESHTARI



PUNIM I DIPLOMËS MASTER

**NDIKIMI I MIKORIZËS NË PARAMETRAT BIOMORFOLOGJIK TË BORONICËS -
KULTIVARËT DUKE, DRAPPER, LIBERTY,**

Mentor:

Prof. asoc. Dr. Vahid Avdiu

Kandidati:

Bsc. Diellza Uka

Prishtinë, 2025

ABSTRAKTI

Ky studim është kryer gjatë vitit 2024, në fshatin Dyz, Komuna e Podujevës në një plantacion 2,59 ha të boronicës pronë familjare në emër të kompanisë “Dyzi Berry fruits”. Boronica (*Vaccinium corymbosum* L.) është një kulturë pemëtare me kërkesa të veçanta ndaj tokës (pH e ulët 4.2-5.2, toka të ajrosura mirë dhe të pasura me materie organike) dhe ujit për ujitje (me EC dhe pH e ulët). Po ashtu konsiderohet një prej frutave me vlerat më të larta ushqyese dhe tregtare. Nga kjo rrjedhë se rritja e rendimenti dhe cilësisë së frutave është një sfidë dhe interes i veçantë. Arritja e kësaj mund të bëhet vetëm përmes zbatimit të teknologjive dhe teknikave të reja të prodhimit. Përhapja e kulturës së boronicës, që po ndodhë kohëve të fundit në vendin tone si dhe në vendet tjera, ka ngjallur shumë pyetje rreth tejkalimit të pengesave dhe gjetjes së formës më të përshtatshme të trajtimit që duhet bërë, që të kemi një rendiment dhe cilësi sa më të lartë për njësi të sipërfaqes. Në rastin tonë janë hulumtuar tre kultivarë të boronicës (Duke Draper dhe Liberty), dhe dy tretmanët me mikorizë (Myco Apply, Nutria Bio + Trichowel) dhe Pa trajtim. Për secilin kultivarë për hulumtim janë marrë nga 9 bimë të vendosura në tri përsëritje. Në studim janë përfshi hulumtimi i parametrave biologjik, morfologjik, pomologjik, prodhues dhe biokimik. Nga rezultatet e fituara është konstatuar se janë shfaqur ndryshime të konsiderueshme në mes të varianteve të testuar. Në rastin konkret kultivari më prodhues ka dalë Liberty, frutat me përmasa më të mëdha kultivari Duke dhe tretmanët me mikorizë (Myco Apply, Nutria Bio + Trichowel) ka dhënë rezultate mjaft të rëndësishme dhe një ndryshim të madh si në rendiment ashtu edhe në cilësi të frutave.

Fjalët kyçe: Boronica, kultivarët, mikoriza, parametrat biomorfologjik